



Prishtinë, 13 qershor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_978_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin e datës 24.10.2017 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja "MCM COMMODITIES" SH.P.K, Adresa: Nëna Terezë, 10000-Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 13 Qershor 2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I VAZHDOHET** Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "MCM COMMODITIES" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li_40/17 për periudhën nga data 02.05.2018 deri 01.05.2023.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 24.10.2017 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike nga ndërmarrja "MCM COMMODITIES" SH.P.K.
 - Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave/dëshmive të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim të këtij aktiviteti dhe ka kërkuar dokumente shtesë, të cilat janë sjellë në Rregullator.
 - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmive të kërkuara sipas aplikacionit, Rregullatori ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.



III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "MCM COMMODITIES" SH.P.K, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji